

INTERVISTË ME ADEM PAJAZITIN

Prishtinë | Data: 21 maj, 2016

Kohëzgjatja: 52 minuta

Të pranishëm:

1. Adem Pajaziti (I intervistuari)
2. Anna Di Lellio (Intervistuesja)
3. Noar Sahiti (Intervistuesi/Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i/e intervistuari/a shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje

Pjesa e Parë

Adem Pajaziti: Unë jam Adem Pajaziti, i lindur me 5 qershor 1951, nga prindërit babai im Shaban Pajaziti dhe nana ime Zoja Pajaziti. Une nanën nuk e maj n'men, nana ka vdekë atëhere kur i kom pasë une dikun dy vite, dhe kom jetu me babën, me gjyshen, pastaj me njerken. Nga babai i kam edhe tri motra edhe tre vëllezër, në t'vërtetë dy motra t'gjalla dhe tre vëllezër. Baba im është martu me nanën time, n'realitet nana ime ka ardhë te burri n'kohën e luftës, atëhere kur ka qenë ni kohë shumë e keqe, dhe ka jetue, ka ardhë pa burrin e vet. Baba im ishte n'luftë, ajo ka dikun pesë-gjashtë muaj përpara n'familje si nuse, pa burrë, derisa baba është kthy prej lufte pastaj. Dhe mas pesë-gjashtë vjete kam lindë une. Ajo prej ni smundje pastaj ka vdekë. Dhe unë kam ni kohë t'gjatë, si fëmi jam rritë me gjyshen, dhe kështu që për nanën kom mendu se gjyshen e kam nanë. Ndërkohë, kur jam rritë pak, diku n'moshën tetë vjeç, atëherë e kom marr vesh prej fëmive, prej shokëve se unë ate nuk e kam nanë, atë e kam gjyshe dhe se nana m'ka vdekë.

Si fëmi kom pasë ni përkujdesje ndoshta ma t'tepërt, ma t'veçantë se sa fëmitë e tjerë për arsye se kam qenë si jetim, mirëpo nuk m'kanë thanë se kam qenë fëmijë i llastuar. Shkollën fillore e kam kry në vendlindje, fshati Çubrel, komuna e Skenderajt. Shkollën e mesme, e kam kry Shkollën e Mesme Normale "Hasan Prishtina" në Mitrovicë, ku edhe jam diplomu si mësues, mirëpo nuk kam punu si mësues. Kam vazhdu studimet në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin Ekonomik, që pas katër vitesh jam diplomue, dhe pastaj kam punue ni kohë t'gjatë në Kuvendin Komunal, në Administratën Shtetërore t'Kuvendit komunal. Ndërkohë, kom punu pastaj n'Prishtinë nëpër institucione shtetërore. Kam qenë Këshilltar i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, kam qenë drejtor i administratës, drejtor i financave. Tani jam në ni kompani t'industrialisë metalike, e udhëheqi ni kompani, jam drejtor ekzekutiv i ni industrie metalike për përpunimin e metaleve.

E nga fëminia ime, si kujtime të jashtëzakonshme dhe me mbresë, mbresëlënëse, m'kujtohet kur te ne vishin mysafirë të ndryshëm dhe kërkonin nga babai im që t'iu rrëfen për masakrën e Tivarit. Ajo ngjarje, si fëmijë m'ka lanë mbresa tronditëse, saqë shpesh herë e pyesja veten se a është e mundur njeriu t'bëj aso masakrash makabre, aso gjërash për t'cilat une n'atë kohë i dëgjojsha edhe si fëmijë, ma vonë pastaj edhe si i rritur, dhe kursesi s'mujsha me mendue se njeriu mundet me qenë aq i ashpër, aq i egër ndaj njeriut.

M'kujtohet në ni moment kur babai fliste për ato gjana, une si temë e pata ngritë në orën e historisë te profesori im, n'shköllën e mesme normale, bash n'atë kohë kur si temë kishmi Luftën Nacional-Çlirimtare. Dhe une e bana si pyetje, i thashë profës tim, thashë, "Ju lutem, a dini me m'tregue si ka mujtë me ndodhë kur brigada e katërt sulmuese malazeze ka vra me mija shqiptarë që kanë qenë t'mobilizumë si partizanë n'Tivar?" Ai reagoi shumë ashpër, duke m'thanë se si po e ndërpres ashtu, "Si po e ndërpre në mësimin, pse po ban aso lloj pyetjesh?" dhe m'qiti jashtë prej orës.

Noar Sahiti: N'cilin vit ka qenë kjo?

Adem Pajaziti: Kjo ka qenë dikun n'vitin '68. Me siguri atëhere ishte ajo situata politike shumë e ranë, ndodhën edhe ngjarjet, demonstratat e vitit '68, e ajo pak a shumë ndoshta ishte frika e njerëzve që të ngriten çashtjet kombëtare. Dhe e di se asnjihere s'kom mujtë me marrë informata zyrtare, deri sa kur kom ardhë n'Universitet, pastaj jam taku me profesorë, ni prej tyre është edhe profesor, doktor, Hakif Bajrami, i cili e ka eksploru këtë çashtje bukur shumë. Ka shku nëpër arkiva, ka marr materiale t'ndryshme, i ka botu si materiale autentike, pa ba intervenime. Ni dokument, "Vjetari", ata e kom pasë edhe une, mirëpo gjatë kësaj luftës t'fundit shtëpia m'u ka kallë me t'gjitha dokumentet, me t'gjitha librat. E kom pasë ni fond t'librave diku rreth 2000 tituj, janë kallë t'gjitha, me shpi e me krejt. Mas luftime e kom bo ni bibliotekë t'vogël.

E kështu që e kom pasë rastin edhe kur kom qenë ushtar i Ushtrisë së ish-Jugosllavisë, domethanë i Jugosllavisë, kësaj që u kanë socialiste, në ni përvjetor të një brigade, brigadës t'katërt sulmuese malazise, kom pasë rastin t'i kem disa oficerë t'asaj kohe, domethanë t'44-tës, si dëshmitarë kishin ardhë n'kazermën tonë. Edhe gjatë ni kokteji, unë isha ushtar atëhere, edhe na u ofruë ni oficer i lartë, që tani ishte civil kuptohet, ai ishte n'pension, dhe po na pyet se si po shkojmë dhe nga jemi. Unë i tregova se nga jam, nga Kosova, edhe ai m'pyti ashtu nga kurtuazia se si po jetojmë këtu, si kalojmë. Unë e shfrytëzova rastin për me e pytë bash për Tivarin, dhe posa e kom përmend rastin e Tivarit ai u largue duke m'thanë, "M'fal se kam një punë, se m'thirri dikush tjetër," dhe nuk dha kurrfarë... unë dojsha me e shfrytëzu rastin se a ka ndonji spjegim për atë gjë që ka ndodhë atëherë.

E tani po iu rrëfej prej babës tim, se qindra here që e kom dëgjue atë storie, atë rrëfim shumë tronditës. Ai tregonte se kah përfundimi i luftës, domethanë n'vitin '44-tën e '45-tën, kish' ndodhë mobilizimi i popullatës për me shku me luftu n'fronte të ndryshme t'luftës. Dhe n'mobilizimin e parë gjyshi im kishte shkue, është i njoftun mobilizimi që i kanë çue shqiptarët e Kosovës në Srem, dhe kanë mbetë vetëm ushqyesit e vetëm t'familjes, domethanë ka ni anëtar i familjes nëpër familje, tjerët t'gjithë kanë qenë t'mobilizumë. Mobilizimi i dytë, atëherë kur e kanë marrë edhe babën tim, është diku n'janar ka fillu, t'45-tës, për arsye se nëpër fronte kishte humbje t'mëdha, gjermanët tërhiqeshin, dhe gjatë tërheqjes kishte bukur shumë... shumë brigada partizane ishin shu' thuaja se krejt, dhe kërkujshin për me i mobilizu.

Mobilizimi që ndodhë atëhere, tregonte baba, i marrin prej komunës tonë Skenderajt dhe i çojnë n'Vuçitërrn, n'Vushtri, n'kamë kuptohet. Prej Vushtrisë gjithashtu prej shumë pjesëve t'ndryshme, rrethi i Mitrovicës, Skenderajt, Vushtrisë, pastaj pjesa e Podujevës, e t'gjithë tjetër, thotë që shkojnë ka Suhareka n'kamë dhe n'Prizren. N'Prizren ka qenë vendtubimi i të gjithëve, prej t'gjitha trevave: prej Tetove, prej Presheve, prej Kumanove, prej... Dhe aty pastaj formohen eshallonet e ndryshme, dhe në ni... sipas asaj që e tregonte baba, me gjasë ka qenë eshaloni i dytë. Gjithsejt kanë qenë gjashtë eshalone. Eshaloni i dytë, dhe fillojnë për me shku për Tivar.

Kanë shkue kah Kukësi, kuptohet n'kamë. Aty ku i ka zanë nata kanë flejt, dhe kanë qenë t'përcjellun me forca ushtarake. Thotë dhe se gjatë tanë kohës, "Asnihere nuk na kanë trajtu si ushtarë që mobilizohen, si popullsi që mobilizohet për front, por si me qenë robë t'luftës, si me qenë reaksionarë, si me qenë..." thotë, "sa që as ujë, kur kishmi nevojë për me pi ujë, mos t'flasim për bukë, nuk na lashin me pi ujë rrugës". Baba tregon, atëherë ka qenë i ri, thotë se nana e vet ia ka dhanë ni strajcë dhe n'strajcë ia ka shti do bukë, ia ka shti do qerapa, edhe dorëza. Me ato thotë, "Kom shkue tanë kohën". Edhe prej Kukësit vazhdojnë pastaj kah Tropoja dhe mbërrinë atje afër Shkodrës. E kalojnë lumin, Drinin, dhe vendosen në pjesën e nënkalasë Rozafa, që është n'Shkodër, nëpër do shtëpia t'djegura, të cilat nuk ishin t'banueshme, t'zbrazëta, por edhe aty vazhdimisht kanë qenë t'rrethumë prej forcave t'armatosura, domethanë prej ushtrisë, prej ushtrisë jugosllave atëhere, të cilët thotë, "Nuk na lajshin asni moment me dalë, edhe nëse kishe pare nuk lajshin me shku me ble bukë ose me ble diçka, ose me pij ujë".

Të nesërmen aty, domethanë kjo ka zgjatë disa ditë, se une nuk e maj n'men sa ditë ka zgjatë udhëtimi i tyre deri n'Shkodër, edhe pse ai e spjegonte në detaje qysh rrugës dikush ka tentu me ikë, edhe thotë, "Veç e kemi ni rrafallim e automatikut, e kemi pasë t'qartë se ata i vranë, i shkatërrunë, kështu që nuk e marrshim guximin për me u largue ashtu n'mënyrë t'dhunshme". N'Shkodër, n'mëngjes herët thotë, "Na kanë çu, edhe e kemi kalu lumin Buna," Bunën, thotë që ka pasë shumë ushtarë... shumë kështu t'mobilizumë, "na kanë qitë disa n'barka, e disa në ni lloj lundre, si trap, asi soj, për me kalu lumin". Lumi shumë i madh, n'barkë... thotë se barkat i kanë zanë ka shtatë-tetë vetë, aty hypshin 15-20 vetë. N'disa

raste thotë se, “E pamë barkën që u fundoske, e ai që s’dijke not,” thotë, se ishte lumi shumë i ashpër, plus asaj ishte kohë e ftoftë, uji i ftoftë, edhe thotë se ata u mbytyshin n’ujë.

“Ata çka shpëtumë dolëm n’atë anë, anena në pjesën e Malit t’Zi, dhe fillumë rrugëtimin qashtu nën përcjelljen e ushtrisë vashdimisht,” thotë, kollonë mbërrinëm deri n’Tivar. E spjegonte Tivarin, thonte, se është, “Hasëm nëpër disa drunj me ngjyrë sikur shelgjet, e atyne vendasit iu thojshin ullij. Ishin drunj bukur t’mëdhenj, me vrima,” spjegonte se si dukej ulliri. Thotë, “N’hyrje poshtë ishte qyteti, dhe shtëpitë fillonin nëpër shpatie me gurishte dhe zbritshin n’atë pjesën e rrafshët”. Thotë, “Kemi mbërrin n’Tivar në një rrugë të drejtë; në një anë ka qenë kanal i ujit, që vazhdimisht shkonte ujë, por na ishmi aq të etur pej rrugës, përveç t’etur edhe t’uritur, po asni nuk na lejojshin me e laku rrugën edhe me pi ujë”.

“Kemi mbërrin,” thotë, “kah fundi i asaj rrugës, n’fund t’asaj rrugës dukej ni shtëpi prej guri, ni shtëpi e madhe diku dy katëshe, bukur e madhe. Aty përfundonte rruga e drejtë. Para se me shku te ajo shtëpi na kanë nalë kolonën, është nalë kolona përpara, edhe afër nesh, dikun 20 metra, ishte ni krue, ujë, burim kështu, rrjedhke krue”. Edhe thotë, “Ni prej kolonës është nda, edhe ka shku e ka shti kokën n’atë krue për me pi ujë”. Ushtari që ka qenë aty thotë që i ka ra me kondak t’pushkës n’kokë, edhe thotë që ai është rrëzu edhe uji i ka ra përmbi. Posa i ka ra uji përmbi ai thotë që u çu qaq shpejt, edhe thotë që ia ka marr atij ushtarit pushkën edhe e ka vra, e ka vra ushtarin prej...

Edhe thotë që atëhere ka ardhë ni oficer, thotë që e kishte nxjerrë alltinë, n’dorë e kishte pishtolin edhe u munojke... atij ushtarit thotë ia morën këta shoktë tonë, domethanë shqiptarët që ishin t’mobilizumë ia murrën pushkën për mos me mujtë me vra të tjerë. Ja murrën edhe tash oficeri erdh’, edhe u mundojke tha... ai e kishte pasë ni shtagë e u munojke me shku me i ra n’kokë, po njerëzit hyjshin n’mes atij që e vrajt atë ushtarin edhe n’mes atij oficerit, saqë në ni moment tha që ia morën edhe p’i dore ia hjekën armën oficerit. Mirëpo dikush tha që gjujti me automatik, edhe tha që ai e kish’ pasë l’shue, “Na u largumë”, tha që u duk pishtolja n’tokë, ai e murr përsëri.

Edhe tha që n’atë moment metën veç ata dy ballë përballë. Ai tha, u munu me i ra me shtagë, ky i ra me pishtol n’kokë edhe ai u rrëzu. Edhe pastaj për s’rati tha që e shprazi komplet, tha i bojke koka kështu {tregon me dorë lëkundjen e kokës poshtë-lart}, derisa e shprazi komplet rafalin që e kishte, fishektë që i kishte në armë.

Pastaj thotë që u ardh’ ni tjetër ushtar, edhe ai e ka zbrazë automatikun t’te. Thotë, “E di, m’kujtohet që ia kanë kputë edhe gishtat, sa i ka qitë kah fytyra rafali”. Thotë, “Neve na kanë urdhënu me u ulë. Edhe ashtu prej krismave na jemi... po kush ka qenë n’kambë përsëri i kanë thanë, ‘Uluni poshtë!’ Jemi ulë, edhe ai ka thanë, ‘Ky është ushtar i ’41-shës’”. Thotë që i ka marrë dhetë: ni, dy, tre, katër dhetë, ushtarët thotë që i

çojshin ma tutje. Tha që iu ka dokë... n'gjuhë serbishte ka thanë, “*Malo je deset, još deset*”, “pak janë dhjetë, edhe dhjetë të tjerë”.

N'dhetëshen e dytë, tha, “Ma ka ngjitë mue,” babës tim. Edhe ata ushtarët, ata dy me pushkë, edhe tash t'u shku me iu bashku asaj dhetshe tjetër, ni kushëri i tina, i babës tim, i thotë... çantën që e ka pasë ai, do tesha sigurisht n'atë çantë, pej asaj guzhve t'madhe i kishte met çanta, edhe ky i pisket tash, “Shaban, merrma çantën!” Ai e merr çantën edhe kthehet temas. Thotë, “N'prezencën e ushtarëve, për me ia pru çantën, edhe unë po du me shku me iu vazhdu atyne, se s'po di, s'jam i vetëdijshëm ça po ndodhë”. Tha, “Ata m'kanë rrok,” se ata ma t'vjetër, kuptohet, “ulu këtu, edhe m'kanë shty mbrapa se tash sigurisht i njehin atje, atje janë veç nanëmbëdhjetë, e duhet me qenë nizat. Mirëpo s'erdh kërkush, edhe shpëtova, edhe pse i ndamë për pushkatim fati deshti, sikur t'i qërohën sytë dhe nuk m'panë kur u ktheva, dhe nuk um kërkunë ma”.

E pastaj tregon aty, “Na kanë urdhënu me hi n'atë ndërtesë, ajo ndërtesë kishte qenë monopol i duhanit”. Kjo do të thotë ka qenë depo për duhan, për grumbullimin e duhanit dhe përpunimin e duhanit. “Kemi fillu me hy mrena,” thotë, “aty te dera ishin dy ushtarë që rrishin me automatik dhe ni tjetër e kishte ni shkop t'metalit edhe secili kah hyke për ni aty, u munojke me ia ngjitë edhe me e fut n'podrum, poshtë”. Thotë, “Ishin disa shkallë që çojshin n'podrum. Ai që ishte i shpejtë u largonte, e nëse u largonte, ai me atë shkopin përpiquej me i sjellë n'kokë ose ku t'i sjellë”. Tha, “Zakonisht, aty n'hyrje, pytshin cili është... e kishin marrë ni njeri peng, ni p'i tonve, edhe thojke, ‘Trego kush ma ka hjekë mu pishtolën prej dorës?’ ai oficeri, ‘Identifikoje ti kah t'hynë këtu.’” Tha që ai s'e dijkë kush ia ka hjekë, kush ia ka marrë për ni moment, [që] ia ka hjekë pishtolën e pastaj e ka gju n'tokë. Ai me qëllim që mos me ndodhë ndonji tragjedi, m'u ftofë ai. Po megjithate ata e kishin qëllimin me ba tragjedi edhe ma t'madhe. Dhe tha që nuk arriti me identifiku se cili është ai, dhe dikur për me e shpëtua veten se atë e pushkatojshin, i tha dikujt palidhje, njanit që nuk reagojke kërkush për ta, se tha që kur i thojke për dikush u gjujshin t'gjithë, “Mos e... pse, ky s'është ai!” e për ata tha që nuk pat kush me thanë, ai “Jo s'jam une!”, tha që e murrën, e pushkatunë.

“Kemi hy,” thotë, “n'ni pjesë, disa mrena n'atë ndërtesë, t'u u mushë ajo,” kishte qenë dy katëshe ajo ndërtesa, e zbazët. Pastaj tregonte që kanë fillu me gjujtë prej t'gjitha anëve, me lloj-lloj armësh, mbi eshalonet që vijshin, pa këputë njerëzit, që iu drejtojshin asaj ndërtesë që e quante Monopoli i Duhanit. Thotë që ajo [shtëpia] filloi të mbushet dhe njerëzit mbetën jashtë. Thotë, “Ne dolëm, kqyrëm nëpërmes dritareve me pa se çka po ndodhë, atëhere fillunë me breshëri armësh t'i godasin edhe muret tona, edhe dritaret, kështu që ne shpejt e shpejt ramë përtokë në patos, në dysheme, e plumat e goditshin anën mbrapa nesh n'muri, e bishin predhat e armëve, bishin te ne aty, përmbi.”

Thotë, “Ndishmi britmë, ushtimën e armatimit prej lloj-lloj armëve, n’tana antë”. Thotë që kjo ka zgjatë me siguri nja ni gjysë ore, pandërpre gjujtje. Ma vonë thotë që janë ni zërat jashtu t’u thanë, “*Prekini paljbu, prekini paljbu!*” do të thotë, “Ndërpreje zjarrin, ndërpreje zjarrin,” thotë zjarri të ndërpritet. Kanë fillue kapak-kapak me u ndalë ajo ushtimë e krismave të armëve. Pastaj thotë që vetëm rrethit ma larg u nishin pushkët t’rralla, e automatiku kohë pas kohe. Thotë, “Janë ardhë afër derës te na aty, kanë kërku për me dalë përjashta. Ne asnja nuk dilshmi nga ndërtesa”. Jashtë thotë që u ndike britma e njerëzve që ishin t’pagumë, dikush kërkojke shqip, tha, “Na i nijshmi t’u kërku ujë, dikush kërkojke ndihmë”.

Tha që dikur u afrunë deri te dera, po që as ata nuk guxoishin me hy mrena, kinse, edhe kërkojshin që me dalë, dikur kërkunë ni përfaqësus, “A ban nja dy përfaqësusë me ardhë me bisedu, se ka qenë ni mosmarrëveshje”. Tha, “Çfarë mosmarrëveshje, ne ishim t’pa armatosun, s’kishmi kurgjo, ishmi t’leckosun, me tesha t’shpisë ashtu”. Thotë që ma vonë fillunë me dalë dy a tre, edhe ngadalë-ngadalë, kur u pa se nuk po i ndodhë kurgja atyne, atëherë dolën t’gjithë. Tha, “Na ofrunë ngat ni muri, edhe na shtinën me i çu durtë përjetë. Knena i kishin përgatitë ushtarët me pushkë. Mendumë se qaty do t’na pushkatojnë tash këta çka kemi mbetë”. Mirëpo thotë se secilin e kanë kontrollu edhe nëpër çanta, edhe nëpër xhepa mos kanë diçka, “Edhe na kanë urdhënu me shku n’drejtimit t’detit. Nuk ishte larg deti, u duke, edhe na kanë qitë n’ni fushë. Derisa kemi kalu,” tha... këpucat, opangat, atëhere i kanë pasë t’gomës ato këpucët e at’hershit, s’ka pasë... edhe me opanga t’lëkurës kush ka qenë, t’marume me dorë, tha, “na u mushshin kamtë plot gjak. Aq shumë gjak rrjedhke n’atë pjesë”.

“M’kujtohet,” thotë, “nji e kom t’njoftëm, ka qenë i nji fshati përtej fshatit tonë atje, i kishte ra automatiku, edhe i kishte ra n’këtë pjesën e mbrapme, edhe iu kish’ ça mishi. Piskatke sa mujke, ‘O vëllazën, ndihmomni, ni dhommni!’ Çka t’i ndihmosh atijna? Iu afru njani, i tha, ‘A p’e don pak ujë?’, tha, ‘Jo, nuk e pij ujin e ktyne, po ndihmomni!’ e kishte rrokë shumë keq. E lamë, s’kishmi... as s’na lashin, menihere ushtari t’mshojke me kondak t’pushkës, ‘Vazhdo tutje!’ Edhe na çunë në ni fushë, knena ishte deti, knena e kishin bo, i kishin qitë ushtarët me automatika me disa rena kështu. U drejtumë edhe na urdhunë me u ulë n’zall; n’atanë deti, knena zall, nejse, knena ishin ushtria. Aty kemi flejt natën, shumë ftoftë po bajke nata afër detit. Ish’ ni erë e ftoftë, plus na ishmi edhe t’untë, e lagtë, e t’gjitha t’kqijat. Gjatë tanë natën nuk pushunë atje n’atë pjesën që e kishmi na me siguri nja pesë qind metra, ose nji mijë metra prej aty ku ishmi na. I dëgjoishmi automjetet tu lëvizë vazhdimisht, tanë natën.

N’mëngjes, diku kah ora tetë janë ardhë me na marrë, me na çu përsëri n’atë ndërtesë. Kur kemi shku aty, e kishin pastru thujse asgjë nuk ka ndodhë; kurgja nuk pashmi, as gjak as kurgja, e kishin pastru. Na futën n’atë ndërtesën, përsëri n’atë Monopolin e Duhanit. Aty kemi nejtë dy netë. Ndërkohë kemi pa, në oborrin e atij kemi pa oficerë anglezë, se e njofshmi uniformën e anglezëve, edhe morrëm informacion se anglezët kanë ardhë me u interesu se gjithë ky... çka ka ndodhë këtu. Nuk e di a ka arritë dikush me i

spjegu mirëpo të nesërmen kanë ardhë përsëri disa oficerë me regjistra dhe kanë kërku se ku janë të tjerët”. Thotë se ata kishin qenë oficerë sllovenë t’cilët ishin ardhë me i marrë t’mobilizumtë, me i veshë, edhe me ia bashkangjitë brigadave t’tyne atje n’Slloveni, se gjermani n’atë kohë ishte kah kalon n’pjesën e Austrisë kah Sllovenia, atje u bajshin luftrat e mëdha, n’pjesën e Dallmacisë, kah Istra.

Thotë, edhe regjistrat... ata i kërkojshin ushtarët, “Ku janë ushtarët e tjerë? Këtu s’paska, pak ushtarë. Ne i kemi regjistrat me shumë ushtarë”. Atëherë thotë, “Na i kemi tregu versionin se si ka ndodhë, çka ka ndodhë me neve”. Edhe thotë se ata u çuditshin, thojshin, “Si është e mundun, qysh ushtarët e vet njeri me i vra, popullin e vet, a është e mundun kjo?” Thotë, “Prej aty na kanë marrë, na kanë çue në Dubrovnik me anije. N’Dubrovnik na kanë veshë me uniformë t’inglizit,” bile thojke ai, uniformë angleze, “na kanë dhanë armatimin, dhe pastaj kemi shkue për Split, Split-Triestë, Triestë-Cele, Cele-Lublanë,” dhe n’atë pjesën e Sllovenisë ky ka shërbye derisa ka përfundu lufta, edhe mas luftime dikun gjashtë mujë e ma tepër ka shërbye nëpër pjesë të Sllovenisë, edhe kur është formue domethanë pushteti i atëhershëm, që e kanë qujtë Pushteti Popullor atje.

Pastaj kur osht’ ardhë vendimi i atëherë pushtetit se lufta ka përfundu dhe njerëzit tash s’kanë ma nevojë me pasë ushtri aq t’madhe, duhet t’kthehen ata, thotë, “T’vjetrit menjihërë i kanë kthy, neve na kanë lanë ma vonë, neve çka jemi kanë t’ri”. Pastaj i kanë ofrue punë, me nejtë atje n’ushtri, n’Slloveni, slloventë. Edhe, nejse ky s’ka pranë, ka dashtë me ardhë n’shpi, edhe u kthy n’shpi. Kur u ardhë n’shpi, e ka gjetë nanën time nuse (buzëqeshë).

Kjo ishte përjetimet e tijna, ai n’fillim hezitonte me i tregu këto, sigurisht prej tmerrit i vinte vështirë me i tregu. Mirëpo njerëzit zakonisht vishin, kur vishin kishin qejf me iu tregu për arsye se ose e kish mixhën dikush, baba i kishte humbë, donte mos ka ndonji element, ndonji njohuri për ata t’humurit, se sot e asaj dite nuk iu dihen... nuk kanë as varre, nuk kanë asni... asni pllakë përkujtimore nuk është. Ne familjarët e këtyre viktimave e kemi ba një Këshill Inicues për ngritjen e një pllake përkujtimore, një obelisku i cili kishte me e përkujtu këtë tragjedi kaq t’madhe. Dhe iu kemi drejtue, tu e pasë parasysh se n’Prizren ka qenë pikëtubimi i krejt t’mobilizumve shqiptarë t’Kosovës edhe t’viseve tjera me shqiptarë, kemi mendu se aty është vendi ma i mirë për me e vendosë ni pllakë përkujtimore. Iu kemi drejtue Kuvendit Komunal n’Prizren edhe sipas njohurive që kam... n’atë Këshill Inicues jam edhe une, sipas informatave që kam Kuvendi e ka marrë ni vendim për caktimin e lokacionit ku do t’vendoset ni pllakë përkujtimore e cila kishte me e pasë si historik t’shkurtë se si ka ndodhë ajo tragjedi aq e madhe.

Noar Sahiti: Kur i krahasoni rrëfimet personale t’babës t’jujë n’raport me burimet që i keni n’dispozicion sa i përket kësaj ngjarje, çfarë konkluzione mundën me u nxjerrë, nëse mundën me u nxjerrë?

Adem Pajaziti: Po une t'tregova, m'ka interesu vazhdimisht kjo për arsye se si fëmijë kam qenë vazhdimisht, sa here e ka spjegju, disa here, sa që intervistën e fundit që e kom ba une këtu, bash ku jam une, këtu e kam ba ni inçizim, e ka shkurtu aq shumë, dhe nuk donte me i hy detaleve, as ni detal nuk donte, veç tregonte... do ta keni ju atë inçizim sigurisht, veç tregonte se si është nisë, si ka shku, ku kanë fletë, ku kanë mbërri kur kanë mbërri atje, çka ka ndodhë, shumë shkurt. Nuk donte domethanë, kur filloi me u plakë ai e kishte mërzi, nuk kishte qejf me iu kthi asaj kohe.

Pjesa e Dytë

Adem Pajaziti: Prej... s'e di saktë, se ai ka qenë... i regjistumë është që ka lindë me 1918-tën. '18-ta... sa p'i bjen aty, '44-ta... goxha bukur shumë i vjetër, mirëpo ai ka qenë i pamartumë atëhere. Ndoshta edhe i kanë shënu ma herët, për shkaqe me i ikë ushtrisë, ose... se '20-'40, dikun 25-26 vjet s'ka pasë ma shumë, aty dikun duhet me i pasë 25-26 vjet. Nana ime ka qenë ma e re shumë se ai, nja pesë vjet ma e re.

E atë pyetjen që ma bane, me i pa n'bazë t'dhanave që i kem, me t'thanë t'drejtën, përveç profesor, doktor, Hakif Bajramit që ka hulumtu nëpër arkiva, dhe ka gjetë dokumente t'Ushtrisë Jugosllave atëhere, me shenjën 'top sekret', që janë dokumente që kanë spjegue se kush ka qenë... ksi, cila brigadë është deshtë me i mobilizu, cila është deshtë me i përcjellë dej n'vend dhe kush ka qenë përgjegjësi n'përcjellje, dhe kujt ka pasë me ia dorëzu atje. Të gjitha qeto dokumente i ka botu Hakifi, ato i kom lexu une. Interesant se n'bazë t'atyne dokumentave, aty shifra dikun mbi pesë mijë njerëz kanë qenë t'mobilizumë, mbi pesë mijë. Tri eshalone, mbi pesë mijë njerëz kanë qenë.

Por edhe baba thonte, dikund e përmendte shifrën, "Rreth gjashtë mijëve," thonte, "kemi qenë. A kur kemi shku, masi që ka ndodhë ajo, një mijë e pesëqind kanë ardhë". Regjistrin s'lloventë kur e kanë marr, që e kanë pasë, thotë që kalojshin fletë t'zbrazëta, domethanë fletë që s'kish' asni njeri. Mas mbrami thotë që një mijë e pesë qind kanë hipë nëpër vapura që kanë shku për Dubrovnik.

E tash me marrë tjera shënime, nuk ka. Pushteti atëherë nuk ka dhanë asni fjalë për këtë, historia fare s'e ka thanë. Une kom dëgju prej profesor, doktor, Hakif Bajramit, tash frik ni ditë, se atëherë n'Komitetin Qendror t'Partisë Komuniste është ngritë kjo çashtje, e ka ngritë dikush. Dhe dikush ka hangër përgjegjësi, po asniherë publikisht nuk është thanë. Kështu që rrëfimet, do t'i shihni edhe prej librave, se janë disa libra që kanë shkru, ka shkru n'formë t'memoareve Azem Hajdini, që ka qenë pjesëmarrës. Edhe njerëzit, kur t'i lexojsh deklaratat e tyne që i kanë dhanë janë pothuajse se identike, dallojnë për ndryshime t'ndryshme emotive, përndryshe rrëfimi historik është i njejtë, është i njejtë.

Të gjithë i kanë ato vuajtje, të gjithë thonë se s'i kanë lanë me pi ujë, se s'iu kanë dhanë ushqim, të gjithë thojnë se s'i kanë trajtu fare si... as si robë t'luftës s'i kanë trajtu. I kanë trajtu diqysh si me qenë njerëz që i çojnë n'pushkatim, praktikisht asisoji si me qenë e përgatitne ajo qysh n'start për me ndodhë bash n'Tivar. Kështu që sa i përket dokumenteve, dhe sa i përket asaj... ma e fuqishme është ajo që e kanë spjegu këta vetë, secili pjesmarrës prej atyne që kanë metë gjallë, se dokumentet e tjera janë asgjësu, s'i kanë... nëpër arkiva s'kanë gjetë, me përjashtim ato që i ka gjetë profesor, doktor, Hakif Bajrami.

Noar Sahiti: Mirëpo ka literaturë ekzistuese që...

Adem Pajaziti: Duhet, duhet me pasë. Është interesant, ajo për t'cilën baba tregonte se kanë qenë ateshe ushtarakë anglezë, n'raportet e tynë për luftën n'atë kohë n'44-tën, sigurisht s'n'arkivat e ushtrisë angleze duhet me pasë dokumentacione t'ndryshme që e thojnë këte. Se dihet, atëhere aleatët kanë qenë edhe pranë Shtabit t'Përgjithshëm t'Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, pranë Titos kanë qenë edhe anglezët edhe amerikanët. Edhe n'atë kohë Shtabi nuk ka qenë larg fort prej Malit t'Zi, është shumë interesant. Sa kom mujtë une për shembull kur isha ushtar, m'interesojke me pa ku ka qenë ajo brigada e katërt sulmuese malazeze. Ajo ka qenë bash n'Sigurimin e Shtabit që u ikë prej Sutjeske, edhe ka ardhë deri n'Mal t'Zi, po nuk ka guxu me u zdjergë poshtë për shkak rrezikut, edhe ni pjesë e qasaj brigade ka qenë bash n'Tivar. Dhe ajo thuhet se është fajtorë, domethanë eprortë e saj janë fajtorë për atë masakër.

Noar Sahiti: Si i kujtoni vitet e fundit t'babës?

Adem Pajaziti: Është interesant, une gjith' tentojsja, i thojsha, "Babë, eja t'marr me veturë, edhe dojna me shkue," masi u hap kufiri me Shqiprinë, "dojna me shku n'Shkodër, e pi Shkodre pastaj me vazhdu kah Katërkolli e dojmë me shku," kah Katërkolli ose Vlladimir që i thojnë malazestë, "e dojmë me shku n'Tivar, edhe dojmë me e pa atë ndërtesën, nëse është ndërtesa, Monopoli i Duhanit aty". Nuk kish qejf, s'dojke, asniherë. Thojke po, por kur vike koha për me e marrë me shku, kur ish' koha e pushimeve, thojsha edhe e bajmë ni pushim e shkojmë, nuk pranojke me ardhë, "Jo, s'muj tash," i ikte asajna.

E n'kohën e fundit, une mora ni iniciativë që me shku bile n'atë pjesë pi Shkodre e deri n'Tivar, me shku qatyne gjurmëve, qatyne fëkembve kah kanë shku ata, me shku vet edhe me ba inçizime t'ndryshme. E mora, është ni vendas i joni, jeton në Ulqin, është historian me profesion, është Nezir Çitaku, ata e kem edhe mik t'shpisë. Djali i tij merret shumë me fotografi, me inçizime t'ndryshme, me belitristikë atje, është Gazmend Çitaku. Dhe po bisedoj me te, po ia tregoj këtë iniciativën time kësisoji, "Po," thotë, "gjithsesi edhe unë ka me t'sigurue se prej literaturës, me babën disa here kemi qenë atyne shkrepave, edhe e di rrugëtimin prej Karërkolli, domethanë posa ta kalojsh Muriçanin edhe hyn n'Mal t'Zi, e di rrugën, është rruga e vjetër, kanë shkru rrazë kreshtave, rrazë bjeshëve kanë shku, deri sa janë shku n'Tivarin e vjetër".

Tivari i vjetër është rrazë mali, ndërsa Tivari i ri është n'rrafsh, afër plazhës, afër detit, n'pjesën që është ultësinë, afër detit.

Dhe ashtu ndodhi, shkova unë me makinë t'tij, me ni Furistradë. Shkumë s'bashku, e mora ni kamerë edhe i kom inçizu ato rrugë der knena n'vend, kur kemi shku te Monopoli i Duhanit. Ndërtesa ishte, dhe besoj që edhe tani është. Për momentin është dikun ni libër, është fotografia, po qe t'a kishmi pasë, po s'e di a mujmë e gjajmë. Kryesorja asht' inçizimi qe e kom ba me qëllim që babës kur t'vij t'ia tregoj, "A po t'bjen n'men," se ishin disa kroje ku tregonte ai që kanë pij ujë, prandej këtë kronin që ka ndodhë incidenti, mandej asht' n'Tivarin e vjetër asht' mbi pesëqind e 60 vjet ni ullij, dru, ullij i vjetër, është nën mbrojtjen e UNESCO-s, dru që ka hy si monument i natyrës, e edhe ata e kom inçizu. Edhe atij... domethanë m'kujtohej mu kur i spjegonte këto sene që, "I kemi pa do t'drunj t'mëdhenj, ishin si shelgje," se ato gjethet i kanë bash si shelgjet tona, thotë, "mirëpo ishin me vrima".

E dojsa me ia tregu atë inçizim, n'mënyrë që a po asociacon edhe a po zgjon atë kujtimin e atëhershëm, a po i kujtohet, a po i identifikon se thotë qyky është kroni, qekjo është rruga, qekjo... ai ish qëllimi im. Edhe e bana inçizimin, erdha. I kishte 86 vjet. Erdha n'Kosovë, edhe shkova me e vizitu, se ai jetonte n'fshat. Shkova me e vizitu, shkova t'mërkurën. Une erdha t'martën, po m'duket prej detit, se isha n'pushim edhe e bana këtë inçizim, edhe shkova t'mërkurën n'mbramje, pi thamë... po harrova me e marr atë... dojsa me e marr kompjuterin komplet për me i tregu edhe inçizimin. Harrova me e marr. Edhe shkova, p'i tregoj kështu, kështu, thashë, "E kam ba inçizimin e rrugës krejt kah keni kalu, prej Shkodre deri n'Tivar, edhe e kom gjetë ndërtesën e Monopolit t'Duhanit".

Ishte qashtu, ndërtesën e kishte ble, ishte privatizu, po nuk ish' prishë destinacioni i saj, për arsye se ishte si monument historik. Malazesët e kishin lanë si monument atë ndërtesë. Edhe kishte roje aty, bile kur shkumë na me hy aty, pak a shumë... se e pahshin regjistrimin, e kisha t'Kosovës, fillunë disa njerëz me çarkullu aty. Nuk guxumë me nejtë shumë. Bamë inçizime, bamë edhe n'atë pjesën mbrapa ku kishin tentu me ikë; ishte distanca mbi dy metra, që nuk kishte mundësi prej dritares me kcy, me dalë, se ishte ni guri i madh, pastaj kodra vazhdonte me mal atje për me hy njerëzit me ikë, që kanë tentu, po s'ka pasë mundësi për shkak se ishte distanca e gjatë prej murit t'shpisë deri te ajo.

E po ia tregoj krejt detajet, edhe thashë, "T'shtunën do t'vij," t'shtunën ish' pushim, "do t'vij, do ta tregoj, do ta shohim bashkë, edhe t'a komentojmë bashkë". "Ani, n'rregull". Ai t'premtën n'mëngjes vdiq, pika n'tru, edhe kurrë s'e pa atë inçizim. Atë inçizim e kam, është shumë prekëse ajo. Nuk arriti kurrë, as për s'gjalli, edhe pse i ndamë për pushkatim nuk dashti asnjherë me shku me i përkujtu ato momente aq tragjike që i ka pa ai, por fati deshti as inçizimin e asaj rruge nuk e pa kurrë.

Noar Sahiti: A ka pasë t' mbijetumë tjerë prej asaj kohe?

Adem Pajaziti: Po.

Noar Sahiti: A ka qëndru n'kontakt me ndonjanin prej tyre përgjatë jetës?

Adem Pajaziti: Është interesant se lufta i lidhë njerëzit shumë. N'fshat tonin kanë qenë dhjetë n'qat', të gjithë kanë mbijetu. Dhe ata disa kanë migru, kanë dalë nëpër tjera, po mendoj n'tjera qytete mrena Kosovës. Por ata që kanë qenë aty janë shoqëru mes veti dhe e kanë pasë ni afërsi, dhe çdo herë i kanë thanë njani-tjetrit si shok i luftës, nuk i ka thanë n'emën po shok i luftës, "Ky shoku i luftës, shoku i luftës." Po asnihere kur janë ba t'gjithë s'bashku, edhe nëse kem pasë iniciativë, ose kem ba përpjekje me i shti me spjegu, as nuk kanë dashtë asnihere me e spjegu. Individualisht e spjegojshin, e tregojshin si ka ndodhë; kur ishin s'bashku nuk dojshin fare, edhe thojshin, "A na keni marrë me na gjyku këtu për këtë rast, a çka po doni? S'e shpjegojmë, s'e tregojmë fare!"

Noar Sahiti: Po për juve personalisht, qysh ka qenë me i vizualizu ose me i pa këto lokacione për t'cilat baba iu ka rrëfy vazhdimisht si fëmijë?

Adem Pajaziti: Po ishte ni emocion jashtëzakonisht i randë, mirëpo ai emocion për t'cilin unë kisha emocion kur e pashë atë kronin, kur mu kujtue ku ka qenë fillimi i masakrës, pastaj ato dyert e monopolit i kom prekë me durtye e mija, dhe m'u dukte... i kqyrsha mos po m'përgjaken ata gurë kur i preka {e tregon shuplakën e dorën sikur ka gjurmë gjaku në të}... edhe dera, edhe dera nuk ishte ndërru; ishte ni derë prej dërrase t'trashë, e u dijkë që shumë është e vjetër. Me përjashtim që mrena kishin ba meremetime, përndryshe, edhe pse vetëm n'korridor na lanë me hy, s'lanë ma tutje me hy, menihere fillunë edhe njerëzit me u afriu aty.

Ai emocion që e pata, filloi me u përzi për arsye se miku me t'cilin isha tha, "Me gjasë është rrezik tash edhe t'jemi këtu ma, se mundet dikush me na sulmue," edhe kështu që ne shpejt e shpejt i mbledhëm ato kamera çka kishim me veti dhe hypëm n'makinë, edhe ikëm. Po ishte e randë ajo, vërtetë ishte e randë! M'duket se edhe hapat nuk ishin njejtë sikur kur t'hecsh shilirë, ishin t'randë. Ishte ni gjendje emotive shumë e randë që t'kujtojshe qe mija njerëz aty kanë dhanë shpirt, kanë derdhë gjak, për çka? Për ni... e pakuptimtë, s'di pse? Për çfarë arsye? Veç pse ka qenë shqiptarë? Veç pse s'e kanë folë ni gjuhë t'tyne? Ose pse ata kanë pasë pretendime ndaj vendit t'tyne, ndaj vendlindjes t'tyne, ndaj tokave t'tyne, ndaj pasurisë t'tyne? Kjo është e pakuptimtë!

Baba ka pasë t' kryme atëhere gjimnazin, që kanë qenë njerëzit e rrallë që kanë qenë t'shkollumë. N'Skenderaj e ka kry gjimnazin n'gjuhën serbo-kroate dhe atje s'ka pasë punë. Si familje, nuk e kanë

punësu n'pushtetin lokal që është formu... n'realitet ende s'ka qenë i formumë. Ka qenë kohë e luftës, domethanë kanë qenë... ai ka punu tokën n'shpi, edhe pse e ka pasë atë shkollë nuk ka punu kërkund. Çështja tjetër ka qenë se baba... gjyshi im, domethanë baba i tina ka qenë i leçitun prej pushtetit për arsye se e ka ndihmue atëhere ni patriot që ka luftu për çashtjen kombëtare n'Kosovë, ni Dervish Koprilla që ka qenë partizan, por që kur e ka pa se ideali për t'cilin ai ka luftue nuk po realizohet, ai ka dalë n'mal, se ai vet ka qenë partizan.

Dhe tash ky e ka përkrah, e ka ndihmue, e ka majtë me bukë, e ka majtë bash afër shtëpive, jo bash n'shpi t'tonën po t'ni kushëri tjetër. Dhe meqë ai nuk i ka dhanë emnat e këtyne kur e kanë zanë, emrin e gjyshit nuk... s'kanë mujtë me e dënu, mirëpo e kanë leçitë, e kanë izolu prej pjesës tjetër. Kështu që edhe baba, edhe pse ka qenë atëhere me gjimnaz nuk i kanë ofru kurrfarë pune. N'atë kohë që ka shku, ka qenë ni djalë i ri që e ka punu tokën, ka majtë bagëti, dhe ka mbijetu si shumë e shumë fshatarë të vet që kanë jetu n'atë kohë.

Noar Sahiti: Po, diçka për fund nëse doni me shtu, ndonji detaj tjetër?

Adem Pajaziti: Po, veç që po shpresoj që tani do ta realizojmë këtë nismën që e kemi nisë për me e ba ni pikë dikun ku mund t'i referohemi atyne viktimave të asaj masakre. Shpresoj se do t'ngritet ai obelisk, ose ajo pllakë përkujtimore n'Prizren. Une shpresoj se edhe historianët tonë, edhe njerëzit e vullnetit t'mirë do t'i hynë arkivave dhe do t'gjejnë material t'a zbardhin, për arsye se pushteti 50 vjet e ka majtë mfsheft atë ngjarje. Dhe nga aspekti moral është obligim i njerëzve me e zbardhë këtë çashtje, që edhe pse njerëzit që e kanë kriju këtë masakër nuk do t'mund t'dënohen, por t'dënohet vepra e keqe, t'dënohet gjenocidi që është ba ndaj atyne njerëzve.

Noar Sahiti: Faleminderit shumë.

Adem Pajaziti: Unë iu falemnderoj juve për iniciativën që keni marrë, n'veçanti Anën, a po?

Noar Sahiti: Po.

Adem Pajaziti: ... për këtë iniciativë. Kjo është vërtetë mahnitëse për neve, dhe asht' ni nder shumë i madh që e ka marrë këtë iniciativë me i zbardhë këto gjana.